



DREJTORIA E ARSIMIT
DIREKCIJA OBRAZOVANJA
DIRECTORATE OF EDUCATION

Tel: 038/200-46005
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

DATA/DATUM/DATE	20.08.2026
NR/ BR	07 Nr./ <u>379</u>
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryesuesit të Kuvendit z. Xhavit Zarkaj
NGA/OD/FROM	Kryetari i Komunës së Ferizajt z. Agim Aliu
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Informatë në lidhje me fillimin e vitit të ri shkollor 2026/27.

INFORMATË

Drejtorja e Arsimit, kërkon nga Kuvendi i Komunës të hyn në rend dite propozimi ynë për informatë në lidhje me fillimin e vitit të ri shkollor 2026/27.

ARSYETIM

Drejtorja e Arsimit vlerëson të rëndësishëm informimin e Kuvendit në lidhje me përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollor 2026/27.

INFORMATË MBI PËRGATITJET PËR FILLIMIN E VITIT SHKOLLOR 2026/2027

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, Drejtoria e Arsimit në Komunën e Ferizajt ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përgatitjen e fillimit të vitit shkollor 2026/2027.

Me qëllim të sigurimit të një procesi edukativo-arsimor cilësor dhe të pandërprerë, Drejtoria ka realizuar analizën e gjendjes në të gjitha institucionet edukativo-arsimore, duke identifikuar nevojat prioritare në aspektin pedagogjik, organizativ, infrastrukturor dhe higjieno-teknik. Në bazë të kësaj analize janë planifikuar dhe realizuar një sërë aktiviteteve që synojnë krijimin e kushteve optimale për fillimin e mbarë të vitit të ri shkollor.

Plotësimi i kuadrit arsimor

Pas përfundimit të vitit shkollor 2026/2027, Drejtoria e Arsimit ka shqyrtuar kërkesat e institucioneve arsimore për plotësimin e kuadrit arsimor, menaxherial dhe teknik, në përputhje me normativat dhe nevojat e paraqitura nga shkollat.

Në këtë drejtim janë zhvilluar të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për rekrutimin e personelit arsimor, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe kriteret e përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës.

Pas përfundimit të procedurave të konkursit, shumica e pozitave të lira janë plotësuar me kuadër profesional dhe të kualifikuar, përveç profileve deficitare, përkatësisht në lëndët:

- Matematikë;
- Fizikë
- Teknologji Informativ dhe Komunikimi (TIK);
- Gjuhë Gjermane,

Regjistrimi i fëmijëve dhe nxënësve

Drejtoria e Arsimit ka ndërmarrë të gjitha veprimet organizative dhe administrative për regjistrimin e fëmijëve dhe nxënësve në institucionet parashkollore, klasat parafilllore, klasën e parë dhe në klasën e dhjetë.

Për vitin shkollor 2026/2027 është planifikuar regjistrimi i:

- 115 fëmijë në kopshte
- 1450 nxënës në klasën parafilllore;
- 1650 nxënës në klasën e parë.

Në bashkëpunim me MASHTI-n është hartuar edhe plani i regjistrimit të nxënësve në klasën e dhjetë.

Sipas planifikimit, në arsimin e mesëm të lartë do të regjistrohen 1670 nxënës, të cilët kanë përfunduar klasën e nëntë në institucionet arsimore të Komunës së Ferizajt, pa përfshirë nxënësit nga komunat tjera.

Procesi i regjistrimit është zhvilluar në dy afate:

- Afati i parë (i rregullt): 7, 8, 9 korrik
- Afati i dytë (plotësues): 17, 18, 19 gusht

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve dhe bashkëpunimi me organizatat partnere

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimitdhënësve mbetet një ndër prioritetet strategjike të Drejtorisë së Arsimit.

Në bashkëpunim me drejtoritë e institucioneve edukativo-arsimore është bërë identifikimi i nevojave për ngritjen profesionale të mësimitdhënësve dhe stafit drejtues.

Në mbështetje të Udhëzimit Administrativ nr. 119/2020 dhe Katalogut të Trajnimeve të Akredituara, shkollat do të vazhdojnë realizimin e trajnimeve me bazë në shkollë.

DKA nga data 17 gusht, për pesë ditë radhazi, ka zhvilluar trajnimin e fushave të kurrikulës për mësimitdhënës të cilët ende nuk e kanë përfunduar këtë trajnim. 105 mësimitdhënës/e e kanë ndjekur trajnimin e lartcekur.

Për realizimin e këtyre aktiviteteve, Drejtoria e Arsimit ka vazhduar bashkëpunimin edhe me organizata partnere që ofrojnë programe të akredituara për ZHPM.

- TOKA,
- KOSED,
- KEC – i,
- Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK),
- Caritasi Zvicran – projekti YEGE,
- Terre des Hommes,

Këto programe synojnë ngritjen e cilësisë së mësimitdhënies, forcimin e kompetencave profesionale të mësimitdhënësve dhe përmirësimin e praktikave pedagogjike.

Furnizimi me tekste mësimore dhe dokumentacion pedagogjik

Drejtorja e Arsimit ka përfunduar të gjitha përgatitjet për furnizimin e institucioneve arsimore me dokumentacionin pedagogjik dhe materialet e nevojshme për fillimin e vitit shkollor.

Komisioni për tekstet mësimore ka vepruar në përputhje me udhëzimet e MASH, duke dorëzuar me kohë kërkesat për furnizimin e nxënësve të klasave I–IX me tekste mësimore.

Edhe gjatë këtij viti vazhdon skema e subvencionimit të teksteve mësimore, përmes së cilës prindërit aplikojnë për rimbursimin e mjeteve financiare për blerjen e librave.

Njëkohësisht, dokumentacioni pedagogjik është përgatitur dhe është shpërndarë në të gjitha institucionet edukativo-arsimore, ndërsa operatorët ekonomik po realizojnë furnizimin e shkollave me materialet e nevojshme didaktike dhe administrative.

Përgatitjet infrastrukturore dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore

Me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për zhvillimin e procesit mësimor, Drejtoria e Arsimit ka realizuar një sërë investimesh dhe ndërhyrjesh infrastrukturore në objektet shkollore.

Në bashkëpunim me operatorët ekonomik janë realizuar punime në renovim, mirëmbajtje, lysterje, përmirësim të oborreve, fushave sportive, parkingjeve, nyjeve sanitare dhe ambienteve të tjera shkollore.

- SHFMU "Billall Shala" Lloshkobare – ndërrimi i çatisë dhe renovimi i klasave
- Gjumnazi "Kuvendi i Arbërit" – lysterja e katit të 2
- IAAP "Faik Konica" – ndërrimi i dierëve të klasave
- SHFMU "Ali Hadri", Mirash – fillimi i ndërtimit i aneksit dhe rregullimi i tribunës për nxënës;
- SHFMU "Vezir Jashari", Ferizaj – përfundimi i rrethojës, fushave sportive,
- SHFMU "Jeronim De Rada", Ferizaj – rregullimi i toaleteve
- SHFMU "Ditura" Dardani – ndërtimi i aneksit për toalete
- Çerdhja në fsh. Greme – ndërtimi i aneksit për kuzhinë
- Drenazhimi i SHFMU "Enver Topalli" në Omuraj, si dhe ndërtimi i depos së druve;
- SHFMU "Konstantin Kristoforidhi" në Neredime, ndërtimi i depos së druve, si dhe hapja e pusit;
- Riparimi i kulmit, rregullimi i oborrit, drenazhimi dhe hapja e pusit në çerdhe në fshatin Babush;
- Hapja e pusit të çerdhja në rrugën "Rexhep Bisliri" në Ferizaj;
- SHFMU "Tefik Çanga" në Ferizaj, zgjerimi i parkingut, rregullimi dhe suvatimi i zyreve;
- SHFMU "Gjon Serreqi" suvatimi, fasadimi dhe shtruarja e lineliumit në 19 klasë;
- SHFMU "4 Prilli" në Zllatar, termoizolimi i jashtëm i shkollës

Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës dhe siguria në shkolla

Siguria e nxënësve dhe e stafit arsimor mbetet një ndër prioritetet e Drejtorisë së Arsimit.

Edhe gjatë vitit shkollor 2026/2027 do të vazhdojë bashkëpunimi me Policinë e Kosovës dhe institucioneve kompetente në realizimin e aktiviteteve parandaluese dhe edukative, përmes ligjëratave dhe fushatave vetëdijesuese në institucionet arsimore.

Njëkohësisht, përmes procedurave të prokurimit publik është siguruar vazhdimi i projektit të sigurimit fizik në shkollat urbane të komunës.

Ky projekt ka dhënë rezultate pozitive në rritjen e sigurisë, ruajtjen e pronës publike dhe krijimin e një ambienti të sigurt dhe të përshtatshëm për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor.

Përfundim

Bazuar në aktivitetet e realizuara dhe në dinamikën e punimeve që janë në përfundim, konstatohet se Drejtoria e Arsimit ka përmbushur obligimet institucionale për përgatitjen e fillimit të vitit shkollor 2026/2027.

Institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Ferizajt janë të përgatitura për të filluar procesin mësimor në kushte të përshtatshme infrastrukturore, organizative dhe profesionale, duke garantuar mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor në përputhje me standardet dhe prioritetet e sistemit arsimor të Republikës së Kosovës.

Drejtorja e Arsimit mbetet e përkushtuar në realizimin e politikave arsimore dhe përmbushjen e objektivave strategjike për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Komunën e Ferizajt. Në bashkëpunim me institucionet arsimore, MASH, institucionet komunale dhe partnerët e tjerë, do të vazhdojë të ndërmarrë veprime konkrete për ngritjen e cilësisë së arsimit, përmirësimin e kushteve të punës dhe krijimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe motivues për të gjithë nxënësit dhe stafin arsimor.